

Përmirësimi i sigurisë ushqimore nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor dhe dialogut



"Përmirësimi i sigurisë ushqimore nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor dhe dialogut" – një projekt nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) në partneritet me Shoqatën "Albanian Food Industry" (AFI). Për këtë projekt SCiDEV ka siguruar mbështetje me një sub-grant nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në kuadër të projektit 'Dialog për zhvillim politikash gjithëpërfshirëse në Shqipëri (ideAL)', financuar nga Bashkimi Evropian në Shqipëri në kuadër të Mbështetjes për Shoqërinë Civile – IPA Civil Society Facility and Media Programme 2018 – 2019.

Përse ky projekt?

Në situatën aktuale në Shqipëri pavarësisht ekzistencës së një sërë organizmash që janë përgjegjës për garantimin e sigurisë ushqimore, procedurat e duhura për të mundur përmbushjen e qëllimit të tyre nuk janë në nivelin e nevojshëm. Relevanca e konsolidimit të praktikave kontrolluese sa vjen dhe rritet duke konsideruar edhe detyrimin e shtetit shqiptar për t'u përafëruar me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Krahas nevojës për përmirësim të sigurisë ushqimore në tërësi, vihet re edhe kërkesa konkrete e Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU) për procedura më të qarta dhe modele transparence mes palëve të mandatuara për inspektim, dhe prodhuesit, tregëtuesit dhe aktorë të tjerë në zinxhirin e vlerës së produkteve ushqimore.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin e sigurisë ushqimore në Shqipëri, përmes analizës, vlerësimit të politikave, përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ, advokimit dhe ndërgjegjësimit të prodhuesve dhe konsumatorëve. Ky qëllim do të realizohet nëpërmjet vlerësimit të gjendjes aktuale të sigurisë ushqimore duke analizuar kuadrin ligjor dhe rregullator, politikat si edhe duke evidentuar mangësitë dhe sfidat në bashkëpunim me aktorët kryesor vendimarrës dhe implementues të sigurisë ushqimore në vend.

Qasja e SCiDEV dhe AFI

Bashkëpunimi midis SCiDEV dhe AFI, synon të hulumtojë, advokojë, dhe llojojë për sigurinë ushqimore, për të ndikuar në ndryshimet sistemike dhe ligjore për më shumë siguri ushqimore për konsumatorin shqiptar duke propozuar modele bazuar në evidenca për zgjidhje strategjike të garantimit të sigurisë ushqimore në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit. Këto modele do të shërbejnë për thjeshtimin e praktikave që mundësojnë zbatimin e standarteve të sigurisë ushqimore nga operatorët ushqimor dhe kontrollueshmërinë përmes monitorimit, inspektimit dhe vetë-raportimit. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ndërgjegjësimit të prodhuesve, konsumatorëve e aktorëve të tjerë në Shqipëri si dhe publikut të gjerë për rëndësinë e sigurisë ushqimore.

Bashkëpunimi me aktorët në sektorin e sigurisë ushqimore

Për realizimin e tij projekti do të bashkëpunojë me institucionet politikëbërëse e legjislative, dhe institucionet përgjegjëse për kontrollin, monitorimin dhe garantimin e sigurisë ushqimore si MBZHR dhe AKU dhe Operatorët e Biznesit Ushqimor (OBU).

Aktivitetet dhe produktet kryesore të projektit

- Një studim vlerësues i bazës ligjore dhe politikave në zbatim në funksion të garantimit të sigurisë ushqimore në vend;
- Dialog dhe konsultim me grupet e interesit për problematikat e gjetura në funksion të hartimit të propozimeve me karakter legjislativ;
- Set dokumentesh praktike, modele transparence dhe formularë tip, për operatorët ushqimorë dhe kontrollorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU-së) për menaxhimin e sistemit të sigurisë ushqimore në nivelin e operatorëve ushqimorë;
- Fushatë komunikimi, angazhimi dhe advokimi me qëllim ndërgjegjësimi mbi sigurinë ushqimore.

Imapkti i pritur i projektit

Projekti vlerëson gjendjen aktuale të sigurisë ushqimore duke analizuar kuadrin ligjor dhe rregullator, politikat si edhe duke evidentuar mangësitë dhe sfidat në bashkëpunim me aktorët kryesor vendimarrës dhe implementues të sigurisë ushqimore në vend.

Projekti propozon modele bazuar në evidenca për zgjidhje strategjike të garantimit të zbatimit të standardeve të sigurisë ushqimore nga operatorët ushqimorë dhe kontrollueshmërinë përmes monitorimit, inspektimit dhe vetë-raportimit në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit.

Projekti mundëson platforma dialogu me aktorët publik dhe privat të përfshirë në politikat dhe praktikatat e sigurisë ushqimore.

Rreth partnerëve

ideAL

'Dialog për zhvillimin gjithëpërfshirës të politikave të bazuara në prova/evidenca në Shqipëri-ideAL' vjen si një përpjekje e përbashkët e Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, dhe Qendrës së Politikave Evropiane (EPC, Belgjikë), mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Si nismë/projekt ideAL synon të kontribuojë në përmirësimin e dialogut të politikave publike në Shqipëri, përmes: (a) forcimit të dialogut të politikave publike në proceset e reformës; (b) lehtësimit të përfshirjes së shoqërisë civile në proces dhe dialog me politikëbërës.

SCiDEV

SCiDEV synon të mbështesë dhe nxisë zhvillimin e qëndrueshëm, ekonomik e shoqëror dhe demokratizimin në Shqipëri e rajon. Për të përmbushur këtë mision SCiDEV punon me akademinë, shoqërinë civile, institucione private dhe publike, në forcimin e inovacionit dhe hulumtimit shkencor, advokimin dhe mbështetjen e përdorimit të të dhënave për nisma ligjore dhe politikëbërëse.

AFI

AFI është një shoqatë gjithëpërfshirëse e bizneseve prodhuese, importuese, eksportuese, përpunuese, tregtuese të lëndëve të para, ndihmëse dhe nënprodukteve, për të gjithë zinxhirin e industrisë ushqimore në Shqipëri.



This project is funded by
the European Union

Kontakt: info@scidevcenter.org
Web: <https://scidevcenter.org/>